


Tiranë më datë 22.05.2019



Lënda: Kërkesë për ekzekutim vullnetar të Pagesës Kalimtare.

Drejtuar: Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori.

Unë Mirela Fana kam ushtruar funksionin e gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Kam dhënë doreheqjen nga detyra që ushtroja duke e paraqitur këtë doreheqje, me shkrim, pranë Presidentit të Republikës, i cili e ka publikuar këtë fakt në faqen zyrtare të institucionit.

Nepermjet shkresës nr.688/1 prot., datë 19.03.2018, Presidenti i Republikës ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për doreheqjen e subjektit të rivleresimit Znj. Mirela Fana në datën 30.01.2017, protokolluar nga ana e Institucionit të Presidentit të Republikës nr. 7/M prot., po me datë 30.01.2017.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivleresimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" ka parashikuar mundësinë e doreheqjes së subjektit të rivleresimit si vijon:

1. Subjekti i rivleresimit ka të drejtë të japë doreheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në faqen e këtij ligji. Doreheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e doreheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivleresimit.

2. Pas dhënies së doreheqjes, subjekti i rivleresimit ka të drejtë të perfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

Në nenin 7 të ligjit 8097 datë 21.3.1996 "PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT" në paragrafin e dytë përcaktohet se: Personave të grupit të parë, që përmenden në shkrojtjen "b" të pikës 8 të nenit: 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të

**funksionit** dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për atë kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Ju bëj me dije se nga momenti i dhënies së dorëheqjes në datë 30.01.2017 e deri më sot, pagesa kalimtare sanksionuar në ligj prej dy pagash mujore të funksionit si Anëtare e Gjykatës së Lartë nuk është ekzektuar nga ju.

Në Vendimin Nr.382, datë 20.5.1996 'PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 "PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT' përcaktohet se:

Në zbatim të nenit 7 të ligjit të mësipërm, shpërblimi do të jepet i menjëhershëm pas largimit nga funksioni a detyra.

1. Pas këtij shpërblimi do të vazhdojnë të marrin pagesën kalimtare: a) në masën 50% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i katërt, personat e paragrafit të parë të nenit 7;

**b) në masën 50% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i tretë, personat e paragrafit të dytë të nenit 7;**

c) në masën 40% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i tretë, personat e paragrafit të tretë të nenit 7. Pagesa e mësipërme do të vazhdojë të jepet për një periudhë kohe jo më të gjatë se afatet e përcaktuara përkatësisht në nenin 7 të këtij ligji.

2.a) Personi nuk merr kompensimin mbi pagë, kur ai punësohet dhe paga e re është më e lartë se paga referuese.

b) Personi do të marrë kompensimin mbi pagë, deri në afate të përcaktuara në këtë nen, kur ai punësohet dhe paga e re është më e ulët se paga referuese. Ky kompensim nuk do të jetë më i lartë se 50% e pagës referuese, të përcaktuar në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 7 të ligjit dhe 40% e saj e përcaktuar në paragrafin e tretë.

### **3. Pagesat e shpërblimit të menjëhershëm bëhen nga punëdhënësi i fundit.**

Referuar vendimit të mësipërm, institucioni juaj në mënyrë flagrante nuk ka zbatuar dispozitat ligjore në fuqi duke mos paguar **shpërblimin e menjëhershëm prej dy pagash** të funksionit të Anëtares së Gjykatës së Lartë, përcaktuar **në pikën 3 të vendimit nr. 382 datë 20.05.1996.**

Gjithashtu, ju bëj me dije se, nga praktika gjyqësore në lidhje me këtë pretendim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 539 (80-2018-543) datë 19.02.2018 ka vendosur detyrimin e Gjykatës së Lartë ti paguajë paditësave shpërblimin e menjëhershëm prej 3 pagash mujore përcaktuar në ligjin 8097 datë 21.3.1996.

Për sa më sipër kërkoj nga ju ekzekutimin vullnetar të Pagesës Kalimtare prej 2 pagash mujore të funksionit si Anëtare e Gjykatës së Lartë.

Me respekt!

Mirela Fana

